



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.92

10 korrik

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7027 datë 20.6.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3779
Udhëzim i MASH nr.19, datë 31.5.2011	Për detajimin e buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë në programin “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”...	3779
Udhëzim i MBUMK nr.11, datë 14.6.2011	Për mënyrën e verifikimit dhe të ndryshimit të zërave kadastralë të tokës bujqësore.....	3782
Urdhër i MBUMK nr.183, datë 26.5.2011	Për tarifën e shërbimeve që kryhen nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark.....	3786
Vendim i ERE nr.50, datë 7.6.2011	Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (hec i Kalivacit), si burim i rinovueshëm energjie.....	3786
Vendim i ERE nr.51, datë 7.6.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Erald Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	3787
Vendim i ERE nr.53, datë 22.6.2011	Për fillimin e procedurave për rishikimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.....	3788
Vendim i ERE nr.54, datë 22.6.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	3788

Vendim i ERE nr.55, datë 22.6.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3789
Vendim i ERE nr.56, datë 22.6.2011	Për kualifikimin e impiantit prodhues e hec Ashta si burim i rinovueshëm energjie.....	3790
Vendim i ERE nr.57, datë 22.6.2011	Për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3790
Vendim i ERE nr.58, datë 22.6.2011	Për licencimin e shoqërisë “DN & NAT Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	3791
Vendim i ERE nr.59, datë 22.6.2011	Për licencimin e shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	3792
Vendim i ERE nr.60, datë 22.6.2011	Për licencimin e shoqërisë “Selishte” sh.p.k.....	3793
Vendim i KKRT nr.159, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Gjirokastrë” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Gjirokastrë”.....	3793
Vendim i KKRT nr.160, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Kombi” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Kombi”.....	3794
Vendim i KKRT nr.161, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Lushnjë” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Lushnjë”.....	3794
Vendim i KKRT nr.162, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Elbasan North” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Elbasan North”.....	3795
Vendim i KKRT nr.163, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Elbasan South” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Elbasan South”.....	3796
Vendim i KKRT nr.164, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Kavajë” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Kavajë”.....	3796
Vendim i KKRT nr.165, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Durrës” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Durrës”.....	3797
Vendim i KKRT nr.166, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Tiranë” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Tiranë”.....	3797
Vendim i KKRT nr.167, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Cable Albania Shkodër” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Cable Albania Shkodër”.....	3798
Vendim i KKRT nr.168, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Epiri 2011” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Tv Kabllor Epiri 2011”.....	3798

Vendim i KKRT nr.169, datë 31.5.2011	Për zgjerimin e zonës së licencimit për televizionin privat kabllor “Tv Kabllor KAM”.....	3799
Vendim i KKRT nr.170, datë 31.5.2011	Për dhënie licence shoqërisë “I-MIRI cable” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “I-MIRI cable”.....	3799
Vendim i KKRT nr.173, datë 31.5.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Sport”.....	3800
Vendim i KKRT nr.174, datë 31.5.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Saranda”.....	3800
Vendim i KKRT nr.181, datë 31.5.2011	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “Tv 11” sh.p.k., licencuar për operatorin televiziv privat kabllor “Tv K8”.....	3801
	Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasit Robert Kovllari dhe Vangjel Kovllari dhe caktimin e Dhora Kovllarit si kujdestare e tyre.....	3802
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Madhi.....	3802

DEKRET
Nr.7027, datë 20.6.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Erol Şevket Kocabaş
2. Kamuran Ridvan İkikardeş
3. Paola Andrea Luis Alberto Montavlo Kërlluku (Montalvo Londono)
4. Savaş Kazim Ūnal
5. Sherif Afet Aljiti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr.19, datë 31.5.2011

PËR DETAJIMIN E BUXHETIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË PROGRAMIN “PËR KËRKIM FONDAMENTAL DHE EKSELENCË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, si dhe të nenit 71 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shpërndarja e burimeve financiare në programin buxhetor “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, dhe përdorimi i tyre të bëhen në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin financiar publik.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, nëpërmjet organeve drejtuese dhe administruese, në përputhje me funksionet e tyre, të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, detajojnë dhe miratojnë buxhetin “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, sipas fakulteteve, instituteve, departamenteve, qendrave kërkimore dhe njësisive të tjera të njëvlershme me to.

3. Fondet e miratuara nga në programin buxhetor 09770, artikulli 602, kapitulli 01, në artikullin 602-606 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, detajohen për çdo IAL dhe fakultet/institut, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur udhëzimit, mbështetur në kriteret e mëposhtme:

a) Numri total fizik i personelit akademik me kohë të plotë për çdo fakultet, pavarësisht nga titujt;

b) Koeficientët e konvertimit sipas fushave të shkencës:

i) shkencat teknike, natyrore, biologjike 1,0;

ii) shkencat shoqërore 0,2;

iii) fushat e artit dhe sportit 0,5;

iv) për Qendrën e Studimeve Albanologjike është përdorur koeficienti favorizues 2,0, sepse: i) ka mision kryesor kërkimin; ii) nuk ka të ardhura të tjera; dhe iii) ka vetëm pak studentë të masterit dhe doktoratës.

c) Numri i personelit akademik i konvertuar për çdo fakultet ($c=a*b$);

d) Fondi total që shpërndahet;

e) Fondi që i takon për çdo punonjës akademik i konvertuar ($e=d/c$);

f) Fondi që i takon çdo IAL dhe fakulteti mbështetur në numrin e personelit akademik të konvertuar dhe fondin për çdo 1 punonjës akademik i konvertuar ($f=c*e$).

4. Fondet e planifikuara në programin buxhetor 09770, artikulli 602, kapitulli 01 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, përdoren për mbulimin e shpenzimeve, si më poshtë vijon:

a) Për blerje materiale që janë të domosdoshme vetëm për realizimin e projektit kërkimor (p.sh., blerje kimikatesh për provat eksperimentale laboratorike ose materiale të tjera të ngjashme), që financohet nga ky fond.

b) Shërbime, udhëtime e dieta që i shërbejnë drejtpërdrejt realizimit të projektit kërkimor, që financohet nga ky fond si marrje provash, kryerje matjesh, intervista/anketime në terren dhe veprimtari të tjera të ngjashme me to. Për shpenzimet e kryera nga punonjësit kur largohen jashtë qendrës së punës ose jashtë shtetit/vendit për çështje pune në bazë të kuotave të përcaktuara nga legjislativi në fuqi.

c) Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, seminare, kongrese, simpoziume, shkëmbim informacioni e të tjera, të ngjashme brenda apo jashtë vendit vetëm për rastet kur punonjësi ka një kontribut shkencor si autor i parë dhe i dytë (referate, postera) dhe kontributi është pjesë e projektit kërkimor që financohet me këtë fond.

d) Transferime korente me jashtë; kuotat e anëtarësimit që jepen për përfaqësime në organizata të ndryshme shkencore jashtë vendit, me statusin e anëtarit apo të vëzhguesit.

5. Fondet e planifikuara në programin buxhetor 09770, artikulli 230-231, kapitulli 06 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, përdoren për mbulimin e shpenzimeve, si më poshtë vijon:

a) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara; shpenzimet që kryhen nga ana e institucionit për krijimin ose blerjen e aktiveve të trupëzuara për qëllime direkte të projektit kërkimor që financohet nga ky fond, shpenzimet e kryera për studime dhe përgatitje projektesh, për blerjen e patentave, të drejtën e autorit, të drejtën e mendimit intelektual, softet informatike të krijuara nga institucioni etj.

b) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara; për krijimin ose blerjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara që i shërbejnë drejtpërsëdrejti realizimit të projektit kërkimor që financohet nga ky fond, si: blerje pajisje dhe instrumente laboratorike, pajisje teknologjike, makineri e pajisje agrikulturore, blerje kafshë pune e prodhimi, pajisje elektronike, për krijim fondi biblioteke, blerjen dhe instalimin e rrjetit kompjuterik, të tjera të kësaj natyre.

6. Fondet e detajuara nga MASH-i për çdo institucion publik të arsimit të lartë në programin buxhetor 09770, artikulli 602, kapitulli 01 “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, detajohet/rishpërndahet për çdo njësi shpenzuese të institucionit, në programin buxhetor 09770, në kapitullin 01 në artikullin 602-606, shpërndahen më tej deri në nivel departamenti (shërbimi në rastin e fushës së shëndetësisë) në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi. Rektorati i paraqet për miratim Këshillit të Administrimit planin e detajuar të shpërndarjes së këtij fondi deri në nivel departamenti (shërbimi në rastin e fushës së shëndetësisë).

7. Fondet e krijuara nga të ardhurat e IAL-së, sipas nenit 74 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të destinuara për mbështetje financiare në programin buxhetor 09770 “Fonde për kërkim fundamental dhe ekselencë”, të miratuara nga Këshilli i Administrimit detajohen nga vetë ato, sipas njësive autonome në bazë të

kritereve të pikës 3, dhe autorizohen për përdorim në programin buxhetor 09770, kapitulli 06, artikulli 230-231.

8. Buxheti i detajuar dhe i miratuar i dërgohet për zbatim dekanateve dhe këto të fundit e dërgojnë në njësitë bazë të IAL-së.

9. Përgjegjësi i njësisë bazë organizon një mbledhje të anëtarëve të njësisë në të cilën i bën të ditur anëtarëve të njësisë buxhetin e akorduar nga ky fond dhe përcakton një afat deri në 4 javë për të dorëzuar aplikimet për projekte kërkimore në bazë të grupeve kërkimore mësimore. Mbledhja mund të marrë vendim për prioritetet dhe numrin e projekteve që do të dorëzohen.

10. Projekti duhet të drejtohet nga personel akademik që zotëron së paku gradën shkencore “Doktor” dhe të ketë formën e kërkuar për projektet në kuadër të programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, duke konsideruar edhe impaktin që ka në realizimin e tezave të masterit shkencor dhe të doktoratës. Në rastet kur në njësinë bazë të IAL-së nuk ka personel të mjaftueshëm me gradën shkencore “Doktor” dhe tituj akademikë, mund të pranohen drejtues të projekteve të jashtme, nga brenda IAL-së ose jashtë saj.

11. Projektet vlerësohen nga grupi i vlerësimit të projekteve, i cili kryesohet nga titullari i njësisë bazë dhe në të bëjnë pjesë titullarët e grupeve mësimore-kërkimore. Në rastet kur njësitë bazë nuk janë organizuar në grupe mësimore-kërkimore, titullari i njësisë bazë emëron së paku dy anëtarë të tjerë të departamentit që zotërojnë gradat dhe titujt më të lartë akademikë dhe kanë përvojë të mjaftueshme në fushën e kërkimit. Kur njësia bazë nuk ka personel të mjaftueshëm me grada dhe tituj, në grupin e vlerësimit thirren anëtarë të jashtëm të njësisë të tjera, që kanë lidhje me fushën që mbulon njësia bazë në fjalë.

12. Projektet prezantohen dhe diskutohen në një mbledhje të njësisë bazë. Në përfundim të saj, grupi i vlerësimit shpall projektet që do të financohen nga fondi për kërkim i njësisë bazë. Lista e projekteve fituese i dërgohet për dijeni dekanatit të njësisë kryesore.

13. Drejtuesit e projekteve fituese bëjnë, brenda një jave, përmirësimet e kërkuara nga grupi i vlerësimit në projekt dhe i dorëzojnë ato së bashku me një plan të hollësishëm të implementimit, si dhe atë të kostos/shpenzimeve të përgjegjësi i njësisë bazë, kancelari i njësisë kryesore dhe kancelari i IAL-së.

14. Për çdo shpenzim që kryhet në kuadër të projektit të miratuar, drejtuesi i projektit duhet të bëjë një kërkesë, të firmosur edhe nga përgjegjësi i njësisë bazë te kancelari i njësisë kryesore. Ky i fundit merr masa për realizimin e menjëhershëm të saj. Në rastet kur menaxhimi financiar është i centralizuar në nivelin e IAL-së, kancelari i njësisë kryesore e dërgon atë menjëherë te kancelari i IAL-së dhe ndjek realizimin e menjëhershëm të saj.

15. Modalitetet e tjera të zbatimit të projekteve, që mbështeten nga ky fond dhe nuk përcaktohen në këtë udhëzim, janë të njëjta me ato të projekteve kërkimore në kuadër të programeve kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.

16. Institucionet publike të arsimit të lartë hartojnë dhe miratojnë në organet e tyre kolegjiale raportet vjetore për përdorimin e fondeve të tyre në programin “Për kërkim fundamental dhe ekselencë”, si pjesë e raportit vjetor financiar të IAL-së.

17. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Auditit në MASH dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.11, datë 14.6.2011

PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT DHE TË NDRYSHIMIT TË ZËRAVE KADASTRALË TË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të kreut VI, pika 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”,

UDHËZOJ:

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ndryshimi i zërave kadastralë të tokës bujqësore” është kalimi i sipërfaqes së tokës bujqësore të zërit kadastral “arë”, që si e tillë figuron në dokumentacionin kadastral, në zërin kadastral “pemëtoare”, “vreshtë” apo “ullishte”, si rezultat i zënies së kësaj sipërfaqeje me kultura drufrutore ose kalimi i zërave kadastralë “pemëtoare”, “vreshtë” apo “ullishte”, në zërin kadastral “arë”, si rezultat i pakësimit të këtyre sipërfaqeve me bimë (kultura) drufrutore.

b) “Zënie e tokës bujqësore me pemëtoare, vreshta dhe ullishte” është gjendja e sipërfaqes së tokës bujqësore, objekt verifikimi, e mbjellë me drufrutorë, në të cilën ekziston më shumë se 50% e numrit mesatar të bimëve për njësi të sipërfaqes (ha).

c) “Numri mesatar i bimëve për njësi të sipërfaqes (ha)” përcaktohet sipas lidhjes nr.1 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) “Pakësimi i tokës bujqësore të zërave kadastralë pemëtoare, vreshtë e ullishte” është gjendja e tokës bujqësore në momentin e verifikimit, ku në sipërfaqet e mbjella me kultura drufrutore numri i bimëve për njësi të sipërfaqes (ha), për shkaqe të ndryshme, është dëmtuar apo pakësuar në masën mbi 50% të numrit mesatar të tyre, dhe që nuk ka leverdi ekonomike mbajtja e kësaj toke për kultivim të drufrutorëve.

2. Ndryshimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore nga zëri kadastral tokë “arë” në zërat kadastralë “pemëtoare”, “vreshtë” dhe “ullishte” ose anasjellas, bëhet vetëm me kërkesë të personave fizikë apo juridikë, të cilët e kanë në pronësi private tokën bujqësore dhe të organeve të qeverisjes vendore apo institucioneve të tjera shtetërore që, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kanë në administrim/përdorim tokën bujqësore.

Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban identitetin e kërkuarit, si dhe arsyen përse kërkohet ndryshimi i zërit kadastral.

Kërkesa shoqërohet me:

a) fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë, administrimit/përdorimit mbi tokën;

b) planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi i zërit kadastral, me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm në shkallën 1:2500 ose 1 :5000;

c) vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut mbi emërtimin e zërit kadastral me të cilën figuron e cilësuar sipërfaqja objekt kërkesë në dokumentacionin kadastral.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi, kërkesat për ndryshim të zërit kadastral të tokës bujqësore i paraqesin pranë DAMT-së së qarkut.

DAMT-ja e qarkut shqyrton kërkesën e paraqitur dhe kur këtë e gjen në përshatje me përcaktimet e pikës 2 të këtij udhëzimi, i drejtohet me kërkesë për verifikim drejtorisë rajonale të bujqësisë (DRB), brenda një muaji nga data e regjistrimit të saj.

Në rastin kur kërkesa nuk është paraqitur sipas përcaktimit në pikën 2 të këtij udhëzimi, DAMT-ja ia kthen subjektit kërkuar.

4. Mbi bazën e kërkesës së DAMT-së qarkut, drejtori i DRB-së, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për verifikim të zënies apo pakësimit të sipërfaqes së tokës bujqësore me pemëtoare, vreshta dhe ullishte, krijon grupin e ekspertëve të verifikimit.

Grupi i ekspertëve përbëhet nga dy specialistë agronomë të DRB-së.

Në përbërje të DRB-së merr pjesë edhe përgjegjësi i zyrës së menaxhimit të mbrojtjes së tokës (ZMMT) të komunës dhe/ose baskisë, në juridiksion të së cilës kryhet verifikimi.

5. Grupi i ekspertëve, të cilit i vihet në dispozicioni i gjithë dokumentacioni i caktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, bën verifikimin në vend të sipërfaqes, objekt i kërkesës për ndryshim të zërit kadastral të tokës bujqësore.

Në përfundim të verifikimit, ky grup përgatit “aktin e verifikimit”, përmbajtja e të cilit pasqyrohet në lidhjen nr.2 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Akti i verifikimit mbahet në tri kopje, nga të cilat njëra ruhet në arkivin e DRB-së, kopja e dytë i dërgohet DAMT-së dhe kopja e tretë dërgohet për informim në MBUMK.

6. DAMT-ja e qarkut, pasi ka marrë “akt verifikimin” nga DRB-ja, mbi bazën e tij kryen veprimet e ndryshimit në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe i lëshon me shkrim “vërtetimin” e këtij ndryshimi, ushtruesit të kërkesës për ndryshim të zërit kadastral, brenda 15 ditëve nga koha e marrjes së “aktit të verifikimit”.

Përmbajtja e vërtetimit pasqyrohet në lidhjen nr.3 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

Lidhja nr.1

NUMRI MESATAR I BIMËVE PËR NJËSI SIPËRFAQEJE (HA) NË KULTURAT
DRUFRUTORE

Nr.	Emërtimi	Numri mesatar i bimëve për ha
1	Mollë mbi mollçinzë	200
2	Mollë mbi n/sh vegjetative	1000
3	Dardhë mbi goricë	200
4	Pjeshkë	500
5	Ftua	300
6	Kajsi	200
7	Kumbull	200
8	Qersh	180
9	Vishnjë	300
10	Dardhë mbi ftua	1000
11	Fiq	160
12	Kaki (hurma)	200
13	Bajame	200
14	Arra	90
15	Lajthi	400
16	Mana kokërr	120
17	Muçmolla dimërore	500
18	Muçmolla verore	330
19	Vodhëza	200
20	Xinxife (hide)	200
21	Shegë	500
22	Portokall	530
23	Limon	330
24	Mandarinë	330
25	Greipfrut	330
26	Ullinj, mbjellje e zakonshme	160
27	Ullinj, mbjellje e dendur	400
28	Vreshta pa ngritur me tel	8000
29	Vreshta tendë	1100
30	Vresht ngritur me tel	3300

Akti i verifikimit të zënies së tokës bujqësore me pemëtoje, vreshta dhe ullishte

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DREJTORIA RAJONALE E BUJQËSISË

AKT-VERIFIKIMI I ZËNIES SË TOKËS BUJQËSORE ME PEMËTOJE, VRESHTA,
ULLISHTE

I mbajtur më datën _____, nga grupi i ekspertëve të DRBUMK-së, përbërë nga:

1. _____
2. _____

Në përbërje të grupit mori pjesë dhe z. përgjegjës i ZMMT-së në komuna/bashki.

Grupi i ekspertëve verifikoi gjendjen e kulturave bujqësore të mbjella në parcelën me nr.kadastral _____ (me nr. pasurie _____) në fshatin (zona kadastrale nr. _____), me sipërfaqe prej _____ m², në pronësi të subjektit _____ dhe rezultoi:

1. Sipas dokumentacionit kadastral të DAMT-së së qarkut kjo sipërfaqe figuron në zërin kadastral _____.
2. Në datën e verifikimit, kjo tokë rezulton e mbjellë me kulturën _____.
3. Sipas deklarimit të subjektit _____ kultivari i mbjellë rezulton “ _____ ”
4. Nga numërimi, matjet dhe sondazhet e kryera, sipërfaqja e kësaj toke disponon _____ bimë/ha.
5. Mbjellja e kësaj kulture është kryer në vitin _____.

Nga treguesit e mësipërm, grupi i ekspertëve e vlerëson këtë tokë bujqësore në zërin kadastral _____ me sipërfaqe _____ m², të zënë me kulturën _____.

Ky akt-verifikimi mbahet në 3 (tri) kopje dhe nënshkruhet:

() () ()

Vërtetimi-tip i ndryshimit të zërave kadastralë
të tokës bujqësore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT _____
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS

VËRTETIM

Mbi ndryshimin e zërit kadastral të tokës bujqësore

Bazuar në “akt-verifikimin” e datës _____, të mbajtur nga grupi i ekspertëve të DRB-së, rezulton:

1. Toka bujqësore që përfshihet në parcelën (ngastrën) me numrin kadastral _____ (nr.pasurie _____), prej _____ m², në fshatin _____ (zona kadastrale nr. _____) është në pronësi/përdorim të subjektit _____.

2. Sipas dokumentacionit kadastral të DAMT-së kjo sipërfaqe ka figuruar në zërin kadastral _____.

3. Nga verifikimi i grupit të ekspertëve të DRB-së, pasqyruar në “aktin e verifikimit” të datës _____, rezulton se kjo ngastër (parcelë) është e zënë me kulturën bujqësore _____.

Mbi sa më lart, bazuar në VKM nr.121, datë 17.2.2011 (kreu VI), Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës e qarkut, sipërfaqen prej _____ m², të kësaj parcele e ka pasqyruar dhe regjistruar në dokumentacionin kadastral në zërin “_____”.

DREJTORI

(_____)

URDHËR
Nr.183, datë 26.5.2011

**PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA DREJTORITË E ADMINISTRIMIT
DHE MBROJTJES SË TOKËS NË QARK**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tarifat e shërbimeve që do të kryhen nga drejtoritë e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës (DAMT) në qark do të jenë:

- Vërtetim pronësie para vitit 1946	1000 lekë;
- Vërtetim pronësie pas vitit 1946	1000 lekë;
- Vërtetim negativ para reformës, për në gjykatë	500 lekë;
- Vërtetim pronësie për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	500 lekë;
- Vërtetim pronësie që kërkohet për statusin të pastrehë	200 lekë;
- Konfirmim i vërtetimeve për ndihmë ekonomike e përkrahje sociale të ardhura nga komuna dhe/ose bashkia	100 lekë;
- Harta e skica planimetricke-kadastrale	1000 lekë;
- Vërtetime për kategorizimin e tokës, sipas bonitetit	1000 lekë;
- Vërtetim me të dhëna nga formulari nr.6	500 lekë.

2. Urdhri nr.482, datë 9.11.2004 “Për tarifat që kryhen nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe”, i Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, shfuqizohet.

3. Ngarkohen drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli

VENDIM
Nr.50, datë 7.6.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“KALIVAC GREEN ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES
(HEC I KALIVACIT), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues të hec “Kalivaci”, si burim i rinovueshëm energjie, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kalivac Green Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d” është plotësuar tërësisht;
 - Neni 7, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” është plotësuar tërësisht;
 - Neni 7, pika 4, germa “a”, “b”, “c” është plotësuar tërësisht.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Kalivac Green Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (heci i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM

Nr.51, datë 7.6.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGETIK” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erald Energjetik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erald Energjetik” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes, neni 9 pika 4.1.5), rezulton në proces realizimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për licencimin e shoqërisë “Erald Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.53, datë 22.6.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË PRAKTIKËS
DHE PROCEDURAVE TË ERE-S**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “k” dhe 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të ERE-s (ERE) në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës, për fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.54, datë 22.6.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EURON ENERGY
GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga

ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Orgjost i Ri”, “Bele 1”, “Bele 2”, “Topojani 1” dhe “Topojani 2”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM

Nr.55, datë 22.6.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “EURON ENERGY GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10, pikat 1, dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa a, dhe 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.56, datë 22.6.2011

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES E HEC ASHTA SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 9 pikat 1 dhe 2/a të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues hec “Ashta”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.57, datë 22.6.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve, 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pikat 1, germa “d”, dhe të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 5 pika 1 germa “g”, 12, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatimi i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM

Nr.58, datë 22.6.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DN & NAT ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 12, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.06.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formatimi i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “DN & NAT ENERGJI” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Kumbull Merkurth” me fuqi 630 kW, për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM

Nr.59, datë 22.6.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve, 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 12, 13, 14, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Sllabinje 2A” me fuqi 2 MW, “Sllabinje 2B” me fuqi 1.6 MW, “Sllabinje 2C” me fuqi 1.8 MW, “Sllabinje 2D” me fuqi 5 MW dhe “Sllabinje 2E” me fuqi 3.4 MW, për një periudhë 30-vjeçare”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.60, datë 22.6.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SELISHTE” SHPK

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 12, 13, dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.6.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Selishta” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Selishte” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Selishte” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Selishte” me fuqi 2 MW për një periudhë 30-vjeçare.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.159, datë 31.5.2011

PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA GJIROKASTËR” SHPK, PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Gjirokastër” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Gjirokastër” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Gjirokastër”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin Gjirokastër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.160, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA KOMBI” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA KOMBI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Kombi” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Kombi” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Kombi”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin Fier.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.161, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA LUSHNJË” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli

Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Lushnjë” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Lushnjë” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Lushnjë”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Lushnjë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.162, datë 31.5.2011

PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA ELBASAN NORTH” SHPK,
PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA ELBASAN NORTH”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Elbasan North” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Elbasan North” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Elbasan North”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Elbasan.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.163, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA ELBASAN SOUTH” SHPK,
PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA ELBASAN SOUTH”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Elbasan South” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Elbasan South” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Elbasan South”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Elbasan.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.164, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA KAVAJË” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA KAVAJË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Kavajë” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Kavajë” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Kavajë”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Kavajë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.165, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA DURRËS” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Durrës” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Durrës” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Durrës”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.166, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA TIRANË” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Tiranë” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Tiranë” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Tiranë”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Tiranë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.167, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “CABLE ALBANIA SHKODËR” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “CABLE ALBANIA SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Cable Albania Shkodër” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cable Albania Shkodër” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Cable Albania Shkodër”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Shkodër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.168, datë 31.5.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “EPIRI 2011” SHPK, PËR TELEVISIONIN PRIVAT
KABLLOR “TV KABLLOR EPIRI 2011”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Epiri 2011” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “Epiri 2011” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për tv kabllor “Epiri 2011”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qarkun Gjirokastrë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.169, datë 31.5.2011

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR KAM”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit Besnik Deliu, për zgjerimin e zonës së licencimit së televisionit privat kabllor “Tv kabllor KAM”

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor KAM”, sipas licencës nr.038 rtv kabllor në komunën Gjoçaj.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.170, datë 31.5.2011

PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “I-MIRI CABLE” SHPK, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “I-MIRI CABLE”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “I-MIRI CABLE” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “I-Miri Cable” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “I-Miri Cable”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal rrethin Korçë.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.173, datë 31.5.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO SPORT”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit “Radio Sport” sh.p.k., dhe propozimin për rinovim licence të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Sport”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 21.10.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.174, datë 31.5.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO SARANDA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit “Media Saranda” sh.p.k., dhe propozimin për rinovim licence të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Saranda”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.181, datë 31.5.2011

**MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT “TV 11” SHPK, LICENCUAR PËR
OPERATORIN TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV K8”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zv/kryetar
Sami Neza	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahimimi	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit “TV 11” sh.p.k., licencuar për operatorin televiziv privat kabllor “TV K8”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 34, pika 4/a dhe neni 124 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Me vendimin nr.827, datë 24.4.2009, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “TV 11” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “TV K8”, duke autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor në fushën e transmetimeve televizive kabllore për një periudhë prej 6 vjetësh, me zonë licencimi bashkitë Sarandë dhe Vlorë, si dhe komunat Golem, Farkë dhe Kashar, me nr.065/RTV kabllor licence. Licenca ka hyrë në fuqi në datën 4.6.2009, pasi në këtë datë është botuar në Fletoren Zyrtare, vendimi nr.827, datë 24.4.2009 i KKRT-së.

Me shkresën nr.6/2 prot., datë 6.4.2011, subjekti “TV 11” sh.p.k., ka depozituar pranë KKRT-së kërkesën për heqjen dorë nga licenca nr.065/RTV kabllor për transmetime televizive kabllore, për arsyet si më poshtë vijon:

“... Megjithëse licenca me nr.065/RTV kabllor ka hyrë në fuqi në datën 4.6.2009, operatori televiziv privat kabllor TV K8 nuk ka dalë asnjëherë në transmetim në gjithë periudhën kohore prej afërsisht dy vjetësh nga momenti i licencimit. Arsyet e mosdaljes në transmetim kanë qenë objektive. Nga ana jonë nuk u arrit të sigurohej penetrimi në zonat e licencimit për shkak të mungesës së kërkesës për këtë shërbim. Gjatë fazës së parë dhe të dytë nuk u siguroa numri i abonentëve të parashikuar, pasi në zonën ku ne jemi licencuar ka operatorë të tjerë kabllorë, të cilët mbulojnë pothuajse të gjithë zonën e transmetimit...”.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 34, pika 4/a “Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur ... nuk ka filluar transmetim pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe 270 ditë në transmetimet e televizionit lokal”.

Të drejtat dhe detyrimet për televizionin privat kabllor janë të njëjta me ato që parashikohen për televizionin privat vendor (lokal). Konkretisht, neni 124 i ligjit përcakton se “Procedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licencës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licencat e transmetimeve radiotelevizive në efir të përshkruara në kreun IV të këtij ligji”.

Nga ana tjetër rezulton se, subjekti televiziv privat kabllor “TV K8” ka detyrime financiare të pashlyera ndaj KKRT-së dhe rezulton të jetë debitor. Konkretisht, totali i detyrimit financiar i subjektit është në shumën 2.216.670 lekë, nga të cilat 800.000 lekë pagesë për licencë për periudhën (vit licencimi) 2009-2010 dhe 1.416.670 lekë pagesë për licencë për periudhën (vit licencimi) 2010-2011.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 34, pika 4/a dhe nenit 124 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën subjektit “TV 11” sh.p.k., për operatorin televiziv privat kabllor “TV K8”.
2. Licenca me nr.065/RTV kabllor e subjektit “TV 11” sh.p.k., për operatorin televiziv privat kabllor “TV K8”, bëhet e pavlefshme.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.1381, datë 1.6.2011, vendosi:
- heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Robert Kovllari, i biri i Jorgjit dhe Dhora Kovllarit, i datëlindjes 13.12.1958, dhe caktimin e kërkuases Dhora Kovllari si kujdestare e tij.
- heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Vangjel Kovllari, i biri i Jorgjit dhe Dhora Kovllarit, i datëlindjes 9.3.1961, dhe caktimin e kërkuases Dhora Kovllari si kujdestare e tij.

KËRKESË

Shtetasi Vasil Madhi i biri i Llambit dhe i Dafinës, i datëlindjes 1.1.1951, lindur dhe banues në Frakull e Madhe, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Artur Madhi, i biri i Vasilit dhe i Elvirës, i datëlindjes 28.7.1982.

KËRKUES
Vasil Madhi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 8.7.2011
Doli nga shtypi më 10.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë